REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. I prot 5407 Më 08-12-2022
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:[1]: **623-22-10958-5-3-6/C437**

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **" IZO - H " SH.P.K., Idriz Gjilani SU-5/ Nr.431 A/-1, Prishtine**, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: **RIPARIMI I NYJEVE SANITARE NË SHFMU "SAPNIQI" NË SAPNIQ – RITENDERIM**

Me numër identifikues: **623-22-10958-5-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Riparimi i Nyjeve Sanitare në SHFMU "Sapniqi" në Sapniq – Ritenderim,** sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë **prej 15 ditë**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **NE FSHATIN SAPNIQ**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[2] (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

---

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

[2] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **8,666.00 €uro;**

[Tetëmijë e gjashtëqindegjashtëdhjetegjashtë Euro e zero Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.
5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **866.60 €uro**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **60 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin te kryej ndonjë ose te gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[Gjykata Themelore Prishtinë]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *[Shqip]*[3] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		**Për Kontraktuesin:**	
Emri:	**Astrit Mullabazi**	**Emri:**	**Izedin Hoti**
Pozita:	**Menaxher i Prokurimit**	**Pozita:**	**Drejtor**
Nënshkrimi:		**Nënshkrimi:**	
Data:	**08.12.2022**	**Data:**	**08.12.2022**
Vula:		**Vula:**	

[3] Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Paramasa dhe Parallogaria e Nyjeve Sanitare

Shkolla:Sapniqi

Vendi:Sapniq

Datë:28.01.2021

Pjesë përberese e Paramases dhe parallogarise - ESHTE EDHE PERSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET DHE SKEMAT GRAFIKE. Ne kuadrin e punimeve te perfshihet - Sjellja e materialeve ne punishte, menaxhimi dhe sigurija e materialeve dhe rrethines se punishte dhe vuarja e materialeve ne veper, perfshi te gjitha punimet dhe aktivitetet ne funksion te finalizimit dhe funksionalizimit te objektit sipas destinacionit per shfrytezim, mirmbajtja e sistemeve deri ne skadim te periudhes se garancionit te punimeve.

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1. Punët Përgatitore					
1.1.1	Mobilizimi i ndërmarjes, punët përgatitore për implementimin e punimeve sipas paramasës ofertuese dhe kontratës mes OE dhe AK.	komplet	1.00	50.00 €	50.00 €
1.1.2	Kontrollimi dhe ruajtja e instalimeve ekzistuese si, ujësjellësit, kanalizimit dhe ato, elektrike gjatë fazës së realizimit të punëve.	komplet	3.00	50.00 €	150.00 €
1.1.3	Pas përfundimit të punimeve duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi gjeneral i objektit si dhe tereni për rreth objektit.	komplet	1.00	50.00 €	50.00 €
				TOTALI POS 1	**250.00 €**
2. Punët e Demolimeve dhe Muratimeve					
	Përshkrimi i pozicionit	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Totali**
2.1.1	Demolimi dhe largimi i mureve ndarëse të toaleteve nga argjila me trashësi 25cm. Materiali demolues deponohet në deponin e caktuar nga investitori.	m²	12.80	5.00 €	64.00 €
2.1.2	Demolimi dhe largimi i keramikave eksistuese ne mure dhe dysheme ekzistues se bashku me të gjitha shtresat ekzistuese, si dhe largimi i tij deri në deponi të caktuar nga Investitori.	m²	36.00	1.00 €	36.00 €
2.1.3	Gëryrja dhe rrafshimi i murit dhe pllafonit te ngjyres dhe suvatimit si dhe pregatitja për suvatim të ri, në pjesën ku nuk ka pllaka të keramikave. Materiali demolues deponohet në deponin e caktuar nga investitori.	m²	69.00	2.00 €	138.00 €
2.1.4	Demolimi dhe largimi i estrihut ekzistues se bashku me të gjitha shtresat ekzistuese, si dhe largimi i tij deri në deponi të caktuar nga investitori.	m²	23.00	1.00 €	23.00 €
2.1.5	Demolimi dhe largimi (kanaleve-vijave)te dyshemeja dhe muret për shtrirjen e gypave të ujit dhe kanalizimit. Materiali demolues deponohet në deponin e caktuar nga Investitori.	komplet	1.00	20.00 €	20.00 €
2.1.6	Demolimi dhe largimi i materialeve tjera, të pa përfshira në pozicione të cilat janë të domosdoshme për implementimin e punimeve.	komplet	1.00	20.00 €	20.00 €
2.1.7	Demolimi dhe largimi i materialit, krijimi i hapjeve për dritare në muret e argjilës 25-30cm me dim.60x80cm, të njejtat të rregullohen si mbrenda dhe jashtë pas montimit të dritareve për të gjitha shtresat ekzistuese, si dhe largimi i materialit të demoluar deri në deponi të caktuar nga investitori.	copë	2.00	50.00 €	100.00 €

2.1.8	Demolimi i betonit dhe depertimi i gypave te kanalizimit ne cokull te betonit si dhe trotuar, largimi i materialit të demoluar deri në deponi të caktuar nga investitori, si dhe rikthimi i gjendjes se meparshme.	komplet	1.00	100.00 €	100.00 €
2.1.9	Demolimi dhe largimi i dyerve ekzistuese me dim.90x210, si dhe largimi i tyre deri në deponi të caktuar nga investitori.	copë	2.00	5.00 €	10.00 €
2.1.10	Furnizimi dhe Muratimi i mureve të brendëshme, t=250 mm dhe t=200 mm, me blloqe të argjiles dhe në llac vazhdues (cement, gelqere; rere). Në llogari të merren edhe brezi shtanges mbi dyrë me armatur konstruktive. Në llogari të përfshihen edhe skelet e nevojëshme.	m²	44.00	20.00 €	880.00 €
				TOTALI POS 2	1,391.00 €

3. Punët e Suvatimit&Keramikës

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
3.1.1	Sjellja e materialit dhe suvatimi i mureve të brenshme dhe plafonit me llaq të parafabrikuar "MP 75", Përfshi: paralyerjet me ngjitës; mbulimet me rrjeta polikarboni në vijat takuese argjille/beton; këndoret metalike dhe të gjithë aksesorët përcjellës standard.	m²	155.00	3.00 €	465.00 €
3.1.2	Sjellja e materialit dhe vendosja e pllakave të keramikës të kl1 në mure 0.8cm (toaletet h=1.5m, përfshi ngjitësin, fugmasën, borduret, profilet këndore në vertikale dhe horizontale dhe aksesorët tjerë përcjellës.	m²	84.00	17.00 €	1,428.00 €
3.1.3	Sjellja e materialit dhe vendosja e fasadës 1.5mm si dhe ngjyrosja e mureve mbi lartësinë e keramikës të vendosur me ngjyrë plastike vetepastruese (sipas përzgjedhjes së invetitorit).	m²	92.00	3.00 €	276.00 €
				TOTALI POS 3	2,169.00 €

4. INSTALIMET E KANALIZIMIT&UJËSJELLËSIT/Punët Tokësore

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
4.1.1	Gërmimi i dheut te kat. III & IV, për kanalet e gypave me thellësi mesatare 1.0m dhe gjërësi 0.6. deri ne kyqje ne rrjetin publik, perfshi dhe panelet mbrojtese gjat punes. Pas montimit të gypave të bëhet kthimi i dheut të gërmuar në kanal, ne shtresa jo me shum se 20cm, perfshi ngjeshjen.	m³	16.00	5.00	80.00
4.1.2	Blerja, transporti dhe shtruarja e rërës rreth gypave të kanalizimit dhe drenazhit	m³	2.00	25.00	50.00
4.1.3	Blerja, transporti dhe shtruarja e materialit drenues sipas detalit	m³	1.50	25.00	37.50
4.1.4	Ndërtimi i pusetës së ujëmatësit. Puseta duhen të jetë e ndërtuat nga betoni i armuar/parafabrikuar me dimensionet të brendshme Ø800mm. Në çmim të llogaritet kapaku metalik.	copë	1	100.00	100.00
				TOTALI POS 4	267.50 €

5 INSTALIMET E KANALIZIMIT&UJËSJELLËSIT/Punët e Kanalizimit

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
5.1.1	Lidhja në rrjetin kryesor publik e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik. Lidhja të bëhet në pusetën ekzistuese. Në çmim të llogaritet shpuarja e pusetës, vendosja e gypit dhe izolimi i vrimës me llaç betoni.	komplet	1	100.00	100.00

5.1.2	Blerja dhe montimi i gypave HT(PP) tre shtresor të tipit "SILENT" të kanalizmit, apo të ngjajshëm dhe pjesëve fazonike, me gjithë materialin e nevojshëm.				
	Ø50mm	m'	20.00	2.00	40.00
	Ø75mm	m'	6.00	3.00	18.00
	Ø110mm	m'	18.00	4.00	72.00
	Ø125mm	m'	6.00	5.00	30.00
	Ø160mm	m'	20.00	6.00	120.00
5.1.3	Blerja dhe montimi i kokës ventiluese nga DN Ø 110 mm. Kjo do të vendoset në fund të vertikales duke e rregulluar me veshje depertimin e siperfaqes së murit.	copë	3	20.00	60.00
5.1.4	Furnizimi dhe montimi i pjeseve per revizion te kanalizimit te cilat vendosen ne lartesi 90 cm.	copë	5	20.00	100.00
5.1.5	Blerja dhe montimi i ujëmbledhësit nga plastika dhe me kapak nga inox-i Ø50mm të shtrënguar për dysheme.	copë	4	20.00	80.00
5.1.6	Mbështjellja e vertikaleve të kanalizimit sipas pershkrimit: * prerja terthore e mbështjelljes , 25x25cm *hapja ne mure nga argjila * izolimi me lesh guri, t=5cm * konstruksioni mbajtes i pllakave te karton gipsit * mbështjellja me pllaka karton gipsi -rezistent në lagështi * perpunimi i lidhjeve dhe fugave	m'	10.00	20.00	200.00
				TOTALI POS 5	820.00 €
6 INSTALIMET E KANALIZIMIT&UJËSJELLËSIT/Punët e Ujësjellësit					
	Përshkrimi i pozicionit	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Totali**
6.1.1	Lidhja në rrjetin kryesor. Në çmim të llogaritet qaforja adekuate, valvula dhe pjesët tjera fazonike të nevojshme për kompletimin e pozicionit.	komplet	1	100.00	100.00
6.1.2	Montimi i pusetes se ujematesit me dimenzione 1.0x1.2x1.0 m dhe pjeseve percjellese : -FF- DN 80 L=400 mm -Valvol Dn-80 mm -Filter i mbeturinave -Montues demontues DN80 -FF- DN- 100/300mm	komplet	1	100.00	100.00
6.1.3	Blerja dhe montimi i gypave të ujësjellësit - UJI I FTOHT. Në këtë pozicion të futen lidhja dhe të gjitha pjesët fazonike të duhura për lidhje, valvulat adeukuate shqyrtimi në shtypje, dezinfektimi i rrjetit dhe material termoizolues i gypave. Presioni punues 1.5-10 Bar.				
	Ø16mm	m'	18.00	2.00	36.00
	Ø20mm	m'	10.00	2.00	20.00
	Ø25mm	m'	5.00	2.00	10.00
	Ø32mm	m'	6.00	2.00	12.00
	Ø40mm	m'	25.00	3.00	75.00
6.1.4	Blerja dhe montimi i gypave të ujësjellësit - UJI I NGROHET. Në këtë pozicion të futen lidhja dhe të gjitha pjesët fazonike të duhura për lidhje, valvulat adeukuate shqyrtimi në shtypje, dezinfektimi i rrjetit dhe material termoizolues i gypave. presioni punues 1.5-10 Bar, temperatura vazhduese 70 $^{\circ}$ temperatura maksimale 90 $^{\circ}$C.,				
	Ø16mm	m'	18.00	2.00	36.00
	Ø20mm	m'	12.00	2.00	24.00
	Ø25mm	m'	6.00	2.00	12.00

	Ø32mm	m'	8.00	2.00	16.00
6.1.5	Furnizimi dhe montimi i kasetave sherndarese te rrjetit neper nyjet sanitare,duke përfshi edhe kolektorët deri në 16 vrima.	copë	2	50.00	100.00
6.1.6	Blerja dhe montimi i njehsorit të ujit(ose rivendosja e njehsorit ekzistues), DN 40 komplet me të gjitha elemente fazonike të duhura (Valvula e thjeshtë, Valvula njëkahore, etj) sipas detalit	copë	1	100.00	100.00
6.1.7	Blerja dhe montimi i nje bojleri elektrik me kapacitet 100 L per ngrohje te ujit sanitar.	copë	1	150.00	150.00
				TOTALI POS 6	791.00 €

7 INSTALIMET E KANALIZIMIT&UJËSJELLËSIT/Punët e Sanitarisë

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
7.1.1	Furnizimi dhe montimi i guaskës, komplet (kazani, gypi, bateritë EK-valvula, gypi i tahretit etj)	copë	3	70.00	210.00
7.1.2	Furnizimi dhe montimi i lavamanit, komplet (bateritë për ujë të nxehtë dhe të ftohtë, sifonin etj)	copë	4	70.00	280.00
7.1.3	Furnizimi dhe montimi i pisuarit, komplet me të gjitha elementet e nevojshme (bateria me senzor, sifoni etj).	copë	1	30.00	30.00
7.1.4	Furnizimi dhe montimi i pjeses ndarëse-murit nga profilet e pvc me panell, në mes të pisoarit dhe lavamanit me dim.50x120cm .	copë	1	30.00	30.00
7.1.5	Furnizimi dhe montimi i pasqyreve për nxënësit si dhe arsimtarët me dim50*60cm.	copë	5	50.00	250.00
7.1.6	Furnizimii, sjellja dhe montimi i solbankave nga pllakat e granitit natyral d=20mm me dim.70*15cm, me pikore dhe mbushjet adekuate hidroizoluese, përfshi aksesorët për ngjitje.	copë	3	50.00	150.00
				TOTALI POS 7	950.00 €
				TOTALI Ujësjellësi dhe Kanalizimi	2,828.50 €

8. PUNËT E NIVELIZIMIT DHE HIDROIZOLIMIT

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
8.1.1	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit ne gjithe siperfaqen e nyjeve sanitare. Ne te përfshihen, stiropori 3+2cm N4(sipas nevojës), shiriti anesor izolues si dhe folija para vendosjes se nivelizimit i cili do jete 5-7cm. Gjithashtu duhet te kete edhe fibra gjate punes per mos plasaritje dhe lidhje me te mire, si dhe aditiv lidhes.	m^2	20.00	12.00 €	240.00 €
8.1.2	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i dyshemese me izolim të ftohët dykomponentësh isomat apo dast, si dhe me lartësi në gjithë muret h=30cm duke përfshirë edhe shiritin lidhës në mes të murit dhe dyshemesë.	m^2	35.00	6.00 €	210.00 €
				TOTALI POS 8	450.00 €

9. PUNËT E ZDRUKTHTARISË

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
9.1.1	Furnizimi, sjellja dhe montimi i dyerve nga materiali pvc te prodhuesit salamander ose ngjajshem, dhe qelqi termopan me xham dyshtresore me dim të derës 80x210cm-sipas skemës "H1".	copë	3.00	150.00 €	450.00 €

9.1.2	Furnizimi, sjellja dhe montimi i dyerve nga materiali pvc te prodhuesit salamander ose ngjajshem, dhe qelqi termopan me xham dyshtresore me dim të derës 90x210cm-sipas skemës "H2".	copë	2.00	150.00 €	300.00 €
9.1.3	Furnizimi, sjellja dhe montimi i dritareve nga materiali pvc te prodhuesit salamander ose ngjajshem, dhe qelqi termopan me xham dyshtresore me dim të dritarës 60x80cm-sipas skemës "H3".	copë	3.00	120.00 €	360.00 €
9.1.4	Fabrikimi, sjellja dhe montimi i dyerve të brenshme, me kornizë nga druri me mbështjellje të komplet murit, dhe panell i furnıruar siç janë ato ekzistuese (derë) druri 40mm. 90x210cm - sipas skemës "Dera - 4".	copë	1.00	150.00 €	150.00 €
				TOTALI POS 9	1,260.00 €

10. PUNËT ELEKTRIKE					
	Përshkrimi i pozicionit	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Totali**
10.1.1	Furnizimi me material dhe shrirja e kabllove 3x1.5 mm² nga ormani kryesor deri te kutia shpërndarëse	m'	55.00	1.00 €	55.00 €
10.1.2	Furnizimi me material dhe montimi i kutisë shprendarëse modulare për vendosjen e ndërpresave dhe prizave,duke përfshi edhe siguresat e nevojshme.	copë	1.00	46.50 €	46.50 €
10.1.3	Furnizimi me material dhe montimi i ndërpëresave dhe prizave të thjesht njëmodular 16A	copë	12.00	3.00 €	36.00 €
10.1.2	Furnizimi me material dhe montimi i trupave ndriques,panell Led 18-24W komplet të parapara sipas normave aktuale.	copë	6.00	30.00 €	180.00 €
				TOTALI POS 10	317.50 €

REKAPITULIMI				
1	**Punët Përgatitore**			**250.00 €**
2	**Punët e Demolimeve dhe Muratimeve**			**1,391.00 €**
3	**Punët e Suvatimit&Keramikës**			**2,169.00 €**
4	**INSTALIMET E KANALIZIMIT&UJËSJELLËSIT**			**2,828.50 €**
5	**PUNËT E NIVELIZIMIT DHE HIDROIZOLIMIT**			**450.00 €**
6	**PUNËT E ZDRUKTHTARISË**			**1,260.00 €**
7	**PUNËT ELEKTRIKE**			**317.50 €**
			TOTALI	**8,666.00 €**

Çmimi duhet të jetë konformë të gjitha fatimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës

Shoqëri Ndërtimtarie Këshilluese IZO - H Prishtinë